

KËRKESË
Nr. 5898, datë 24.11.2021

PËR BOTIMIN E VENDIMIT PËR DËNIM ADMINISTRATIV NDAJ SUBJEKTIT
“FTELEA”

Agjencia Kombëtare e Mjedisit përgjatë ushtrimit të veprimtarisë së vet po përballet në pengesa për mosrealizimin e njoftimeve të akteve administrative ndaj kundërvajtësve në fushën e mjedisit.

Për këtë arsye, AKM-ja, me qëllim realizimin e objektivave të vendimit të Këshillit të Ministrave, dërgon fletëthirrjen dhe zbardh vendimin e Komisionit të Ankimit për subjektin.

Agjencia Kombëtare e Mjedisit, megjithëse ka realizuar njoftimin e fletëthirrjes zyrtare nëpërmjet shërbimit postar, në këtë rast është kthyer njoftimi i institucionit me konfirmimin nga shërbimi postar: “Largimi i subjektit nga ajo adresë”.

Sa më sipër, Agjencia Kombëtare e Mjedisit bën njoftimin publik të fletëthirrjes me nr. 5165, prot., datë 27.10.2021, si dhe vendimin e Komisionit të Ankimit me nr. 5652, datë 12.11.2021:

1. “FTELEA”.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Edison Konomi

FLETËTHIRRJE
Nr. 5165 prot., datë 27.10.2021

Subjektit “FTELEA” sh.p.k.

Lagjia nr. 1, rruga “Turizëm”–“Kanali i Çukës”, përballë supermarket SPAR, Sarandë

Për nevoja të shqyrtimit të ankimit administrativ nga komisioni i ngritur pranë AKM-së Qendër, në lidhje me vendimin përfundimtar të inspektimit nr. AKM-FR-2021-000032-5, datë 29.7.2021, marrë nga inspektorët e Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastrë.

Ju njoftojmë të merrni pjesë në shqyrtimin që do t’i bëhet kundërvajtjes administrative më datë **2.11.2021, ora 09:45.**

Paraqitja të realizohet personalisht ose nga një person i autorizuar nga ana juaj. Në rast mosparaqitjeje, shqyrtimi nuk pezullohet, por do të vijohet në mungesë.

Ky njoftim realizohet me anë të shërbimit postar ose nëpërmjet strukturave të AKM-së.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Edison Konomi

**VENDIM
I KOMISIONIT TË ANKIMIT**

Në bazë të pikës 2, të nenit 51, të ligjit 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”; të VKM-së nr. 568, datë 17.7.2019, “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit”, të ndryshuar me vendimin nr. 186, datë 25.3.2021, “Për një shtesë në vendimin nr. 568, datë 17.7.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit”, për vendimin përfundimtar **nr. AKM-FR-2021-000032-5, datë 29.7.2021, të Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier/Vlorë/Gjirokastrë, ndaj subjektit “FTELEA”,**

Komisioni:

Sa më sipër, nga analiza e fakteve të pretenduara nga të dyja palët, arsyeton se gjatë marrjes së masës administrative nga grupi i inspektimit nuk është marrë parasysh pika 2 e nenit 6, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, i cili citon, se: “2. Në përcaktimin e dënimit apo të masës që duhet marrë, inspektori, në përputhje me rëndësinë e shkeljeve të konstatuara apo pasojave të tyre, vendos atë sanksion apo merr atë masë që është domosdoshme dhe e përshtatshme për arritjen e qëllimit të dënimit apo masës dhe që cenon më pak të drejtat apo interesat e ligjshëm të subjektit të inspektimit.”.

Pasi shqyrtoi ankimin dhe masën administrative, në mbështetje të pikës 4, të nenit 137, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”,

VENDOSI:

Ndryshimin e vendimit nr. AKM-FR-2021-000032-5, datë 29.7.2021, të Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier/Vlorë/Gjirokastrë, ndaj subjektit “FTELEA”, nga 500.000 lekë në 300.000 lekë dhe pranimin pjesërisht të ankimit ndaj këtij akti administrativ.

Ky akt hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Edison Konomi

Kundër vendimit përfundimtar mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë.